



BPrAL - PPOHE
Kolegji AAB

DEGA - GJAKOVË

***DREJTIMI: MENAXHMENT DHE INFORMATIKË
& MARKETING DHE ADMINISTRIM BIZNESI***

Lënda:

INFORMATIKA E BIZNESIT

Mësimdhënësi

MSc.Florent Bunjaku, PhD cand.

1

Viti akademik 2014/2015

Ligji i minimumit të cilësisë së sistemit informativ të menaxhmentit,


(Richard Nolan)

- *Cilësia e sistemit informativ të menaxhmentit është e barabartë me cilësinë e komponentit më të dobët të tij.*
- Vetëm me analizën e cilësisë të të gjitha komponenteve do të jetë e mundur që të fitohet një pasqyrë për kualitetin global të sistemit.

STRUKTURA E VENDOSJES DHE HORIZONTI KOHOR I VENDIMEVE

Struktura konceptuale e vendimmarrjes zhvillohet në bazë të analizës së horizontit kohor të vendimeve:

- ✓ Vendimet **afatgjate** (strategjike)
- ✓ Vendimet **afatmesme** (taktike)
- ✓ Vendimet **afatshkurta** (operative)



Vendimet afatgjate (strategjike)

- Merren nga nivelet më të larta të menaxhmentit, pra periudhat prej disa viteve. Në këtë udhëheqje hyjnë të gjitha vendimet **strategjike**. Pasojat e vendimeve të tilla janë afatgjata, ndërsa dëmet nga gabimet eventuale të vendimmarrjes janë të mëdha.


Vendimet afatmesme (taktike)

- Merren nga nivelet e mesme të menaxhmentit, pra periudhat prej disa ditësh deri në disa viteve (numri më i vogël). Dimensionin kohor nuk është i definuar plotësisht sepse varet nga veqoritë e procesit afarist. Gabimet eventuale në këtë nivel mund të jenë të konsiderueshme por jo edhe aq të mëdha.

Vendimet afatshkurta (operative)

- Merren nga nivelet e mesme të menaxhmentit, pra vendimet afatshkurta në praktikë ka të bëjë me horizontin kohor prej disa ditësh. Me to ndihmohet zbatimi në vepër i vendimeve të marra në nivelet më të larta.

STRUKTURA E VENDOSJES DHE HORIZONTI KOHOR I VENDIMEVE




Struktura e menaxhmentit

**Udhëheqja
supreme**

**Udhëheqja
ekzekutuese**

**Udhëheqja
operative**



Horizonti kohor i vendimarrjes

Shembull

- Me një vështrim të gjendjes në tragun e prodhimeve higjienike është konstatuar se është në rritje kërkesa e tregut për produktet.
- Udhëheqja **superiore**, me ndihmën e këshilltarëve profesional merr vendimin për të prodhuar, p.sh. Detergjent të ri për larje të rrobave
- Udhëheqja ekzekutive do të jetë ngarkuar për krijimin e kushteve në të cilat, një **program prodhues** i ri mund të filloj dhe të realizohet në treg, si dhe nxerrjen e vendimeve konkrete lidhur me to.

- Shërbimi për **hulumtim** (recepturën)
- Shërbimi i **marketingut** (pritjet e konsumatorëve, mënyra e paketimit etj.)
- Shërbimi i **prodhimit** (makinat e nevojshme për prodhim)
- Shërbimi **financiar** (investimet në prodhim, kalkulimet për çmimin adekuat, edukimi i personelit për shitje etj)

- Udhëheqja e sektoreve të të gjitha shërbimeve të cilat marrin pjesë në realizimin e projektit të prodhimit të detergjentit të ri përgatisin terrenin për prodhim të papengueshëm.


Modelet e organizimit të sistemit informativ të menaxhmentit të biznesit

Modeli i sistemit informativ të menaxhmentit të biznesit i cili përfshin minimumin e funksioneve afariste bazë quhet **model standard i organizimit**.

Sistemi informativ i menaxhmentit të biznesit përbëhet nga këto **nënsteme**:

1. I planifikimit dhe analizës së procesit afarist,
2. I qeverisjes me të mira materiale,
3. I qeverisjes me resurse njerzore,
4. I udhëheqjes me financa,
5. I prokurimit (furnizimit me material),
6. I prodhimitarisë,
7. I shitjes së mallrave,
8. I hulumtimit dhe zhvillimit.


- Modeli në të cilin dominon bindja se prodhimi paraqet funksionin kryesor afarist, kurse funksionet tjera janë servis i tij quhet model i dominimit të prodhimit



NSI – Nën sistemi i sistemit informativ


Modeli i prodhimtarisë dominante

- Modeli i ri standard i sistemit informativ të udhëheqjeve afariste. Edhe ku sistem në mjediset e ekspertëve me të shpejt morri emrin jozyrtar **modeli i nënsistemeve ekuipotente**.



Modeli i nënsistemit ekuipotent


1. Nën sistemi informativ i **klasifikimit dhe shifrimit**
2. Nën sistemi informativ i **hulumtimit të burimeve të blerjes**
3. Nën sistemi informativ i **programimit të blerjes**
4. Nën sistemi informativ i **qeverisjes me blerje**
5. Nën sistemi informativ i **regjistrimit të hyrjes së lëndës së parë**
6. Nën sistemi informativ i **qeverisjes fizike me material**
7. Nën sistemi informativ i **përlllogaritjes së daljeve të lëndës së parë**
8. Nën sistemi informativ i **përlllogaritjes së shpenzimeve të furnizimit**
9. Nën sistemi informativ i **statistikave dhe analizës së blerjes**



Struktura e sistemit ekzekutues të furnizimit (prokurimit)

Metodat e kompjuterizimit të shfrytëzuesit të fundit

Ideja udhëheqëse në të cilën e ka zanafillën metoda e kompjuterizimit të shfrytëzuesit të fundit është kyqja aktive e atyre për kërkesat e të cilave sistemi informativ është vendosur.



Zhvillimi i mënyrës së përpunimit të të dhënave

Në prespektiven historike, vështruar nga aspekti i sotëm, fazat e zhvillimit të përpunimit të të dhënave ndahen në:

1. Faza **manuale** (me dorë)
2. Faza **mekanike**
3. Faza **elektromekanike**
4. Faza **elektronike**

Faza manuale e përpunimit të të dhënave daton qysh nga kohët e barbarëve, kur njeriu nuk shfrytëzonte asnjë mjet të krijuar artificialisht për ndihmë me rastin e përpunimit të të dhënave.

Faza mekanike paisjet më të njohura mekanike, të calat e kanë shënuar këtë fazë janë 1817 makina e shkrimit, 1843 telegrafi i Morseut. Kanë mundësuar përpunimin e sasive me të mëdha të të dhënave, rezultatet ishin të sakta dhe precize.

Faza elektromekanike në vitin 1881, filloj faza elektromekanike e përpunimit të të dhënave. Më 1924 u zhvillua kompania International Business Machines (IBM), e cila edhe sot është prodhuesi më i madh i paisjeve informatike.

Faza elektronike me kalimin e kohës paisjeve elektromekanike iu janë shtuar edhe shumë komponente elektronike me çka ato kanë fituar shpejtësi, saktësi dhe precizitet.

ORGANIZIMI I TË DHËNAVE

Sistemi informatik i përpunon të dhënat dhe i shëndrton ato në informata.

Për të kuptuar strukturën e informatave është me rëndësi të kuptojmë se çka janë elementet vijuese të semiotikës:

- **sinjali** - ngjarje me përmasa fizike që emitohet nga burimi dhe interpretohet nga marrësi,
- **porosia** – bashkësia e sinjaleve e formuar sipas një rregulli të caktuar dhe e kuptueshme për partnerin komunikues,
- **e dhëna** – bashkësia e disa porosisve e formuar sipas një rregulli logjik në procesin e komunikimit.

Sinjalet shprehen me anë të simboleve dhe shenjave dhe mund të jenë:

- sinjale hapësinore (emetohen si numra, shkronja në CD, kartela etj)
 - sinjale kohore (impulse elektrike, magnetike, optike etj.),
 - sinjale të kombinuara (fotografi, zë, tekst në ekranin optik).
- **Bashkësia e sinjaleve** e formuar sipas një rregulli të caktuar dhe e kuptueshme për partnerët komunikues formon **porosin**.
- Porosia zakonisht ndërlidhet me objektin e caktuar dhe si e veqar nuk flet shumë.
- **Bashkësia e disa porosive** e formuar sipas një rregulli të caktuar logjik në procesin e komunikimit formon **të dhënat**.

Shembull: Numri “100” shpreh një kuptim, por si i veqar nuk flet shume.

Shembull: Fjalitë “Studentët e vitit të dytë” dhe “ishin prezent në ligjerata” janë të **dhëna**, mirpo për tu shëndruar në **informatë** duhet të përpunohen. Nëse themi “Studentët e vitit të dytë ishin prezent në ligjerata” kemi një informatë e cila mund të nxit ndonjë aktivitet qeverisës.

PAMJA LOGJIKE DHE FIZIKE E TË DHËNAVE

Të dhënat zakonisht manifestojnë me ndonjë ngjarje. Meqenëse ngjarjet mund të jenë të ndryshme atëherë edhe të dhënat janë të ndryshme. Mund të thuhet se ngjarjet e thjeshta krijojnë të dhëna të thjeshta, kurse ngjarjet e ndërlikuara krijojnë të dhëna të ndërlikuara.

Ndërlikueshmëria mund të shiqohet nga aspekti:

1. Fizik dhe
2. Logjik

Pamja logjike e të dhënave

Dizajnimi logjik është një model abstrakt i cili përshkruan se si janë të grupuara të dhënat, pra raporti në mes të simboleve, shenjave dhe sinjaleve.

Pamja logjike e të dhënave përmban:

1. **Shenjat** (*Character-elemente të alfabetit abcd, ose numrave*),
2. **Fushën e të dhënave** (*Data file-vargu i shenjave që ka ndonjë kuptim për njeriun*),
3. **Segmentin e të dhënave** (*Segment Data- fusha të përfërta të dhënave të lidhura me ndonjë objekt*),
4. **Datotekën logjike të të dhënave** (*Logical Data file – bashkësi e rregulluar dhe organizuar e radhëve të dhënave*).

Pamja fizike e të dhënave

Pamja fizike shpreh karakteristikat e të dhënave në përmasa fizike (kodi, gjatësia, mënyra e memorimit etj.) dhe zhvillohet nga specialistët.

Njësia elementare fizike e të dhënave është definuar nga Shanon, për mundësinë e matjes së sasisë së informatave.


Organizimi hierarkik i të dhënave nga Sistemi kompjuterik fillon nga:

1. Bit-et,
2. Bit-ët → në Bajt-ë,
3. Bajt-ët grupohen → në vargje ose Blloqe (Block),
4. Blloqet → në datoteka (Data File),
5. Datotekat → në bazën e të dhënave (Database).

Qëllimi i organizimit të dhënave në bazën e të dhënave duhet ti shërbejë manipulimit më të shpejtë me to.


Baza e të dhënave në një **ndërmarrje prodhuese** përmban:

- datotekën e prodhimit,
- datotekën e furnitorëve,
- datotekën e blerësve,
- datotekën e të punësuarve,
- datotekën e porosive,
- datotekën e materialit etj



Paraqitja hierarkike e pamjes fizike të të dhënave fillon nga njësia elementare kah njësia më e madhe përkatësisht (biti, bajti, blloku i të dhënave, datoteka fizike e të dhënave).

Këto njësi paraqesin numra dekad të cilëve ju jepet prefiksi: Kilo ($=10^3$), mega ($=10^6$), giga ($=10^9$), tera ($=10^{12}$)
Pra me njësitë përaktëse bëhet matja e **kapacitetit të memorjes**.



Hierarkia e pamjes logjike dhe fizike të të dhënave

Kodimi në informatikë

Kodimi paraqet një veprim i cili nënkupton shëndrimin apo transferimin e informatave nga një formë në tjetrën.

Varësisht nga njësia e kodimit dallojmë kodimin e orientuar:

- në **domethënie** (*përkthimi i ndonjë vepre, etj.*)
- në **porosi** (*pororsia në gjuhën angleze “Help” në gjuhën shqipe “Ndihmë”*)
- në **shenja** (*duke u bazuar në shenja përkatëse*)

Sipas parimeve të kodimit, shndërrimi duhet të bëhet sipas rregullave të kodimit, të definuara më parë që janë të njohura nga pjesëmarrësit në komunikim; njeriu dhe makina.

Kodet standarde janë 8 bitëshe dhe 256 sinjale= 8 kombinime binare:

- 1. EBCDIC (Extended Binary Coded Decimal Interchange Code),
- 2. ASCII (American Standard Code for Information Interchange).

Ç'do kompjuter njih së paku një kod standard, zakonisht ASCII, ku në bazë të tabelave bëhet shndërrimi nga një formë në tjetrën në mënyrë automatike.

Aplikimi i teknologjisë parainformative

- Meqenëse informatika, në kohën e sotme ka depërtuar në gjitha sferat e jetës edhe teknologjia parainformative përvetëson tregje gjithnjë e më të mëdha.
- Aplikimi në aktivitetet ushtarake (armatimi, radarët, përgjuesit, vëzhguesit etj)
- Aplikimi në mjekësi (tomografia kompjuterike CT)
- Aplikimi në industrinë e argëtimit (lojrat, automatët etj)
- Aplikimi në veprimtarinë qarkulluese (trafik)
- Aplikimi në arsim
- Aplikimi në industrinë botuese
- Aplikimi në kulturë